




Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT  
REGULATORNI AUTORITETI ZA USLUGE VODE  
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



DATË/A	23.12.2024
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Kryeshefit Ekzekutiv te KRU-ve
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hajrije Morina, Drejtoreshë e ARRU
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Heqja e ndër-subvencionimit në mes konsumatorëve jo shtëpiak dhe shtëpiak

Te nderuar,

Struktura aktuale tarifore parashikon aplikimin e ndër-subvencionimit të konsumatorët jo-shtëpiak për konsumatorët shtëpiak. Konsumatorët jo-shtëpiak paguajnë tarifa 50% më të larta për ujë dhe 120% tarifa më të larta për ujëra të ndotur krahasuar me konsumatorët shtëpiak.

Ky ndër-subvencionim aplikohet gjithashtu edhe për tarifën fikse mujore, por përmes rishikimit të metodologjisë tarifore, është vendim i ARRU-së që të zëvendësojë këtë me tarifë fikse të bazuara në madhësinë e ujëmatësimit.

Politika tarifore e ARRU, që nga viti 2009, e ka pranuar se ndër-subvencionimi për furnizimin me ujë është i paefektshëm dhe duhet të hiqet gradualisht. Edhe pse ky ndër-subvencionim është zvogëluar me kalimin e kohës, konsiderojmë se kjo mund të përshpejtohet pa efekte të dëmshme materiale ndaj konsumatorëve.

Për tarifën e ujërave të ndotura, ARRU mendon se ndër-subvencionimi mund të mbetet me arsyetimin se shumë konsumatorë jo-shtëpiak janë ndotës më të mëdhenjë se sa konsumatorët shtëpiak. Megjithatë, nëse ARRU vendosë të aplikojë tarifa për ujëra të ndotura që marrin në konsideratë cilësinë e ujërave të ndotura, atëherë kjo e eliminon nevojën për ndër-subvencionim.

Konsultimi ynë publik i janarit të vitit 2024 përfshinte një propozim për heqjen e ndër-subvencionimit për të përmirësuar koston reflektive dhe efektshmërinë e përgjithshme ekonomike. Përgjigjet nga konsultimi publik e mbështesnin këtë propozim, por që do të realizohej brenda disa viteve dhe jo një heqje të menjëhershme.

Analiza e ARRU sugjeron se heqja e plotë e ndër-subvencionimit do të rezultojë në rritjen e tarifave për konsumatorët shtëpiak me rreth 7% në krahasim me tarifën ekzistuese. ARRU është e bindur se një rritje e tillë e menjëhershme e tarifës së kësaj magnitudo mund të krijojë vështirësi për disa konsumatorë. Prandaj, pozicioni i ARRU-së është që heqja e ndër-subvencionimit të shtrihet gjatë periudhës së cikleve të shqyrtimit tarifor 2026-2028 dhe 2029-2031.

Shtojca A e kësaj letre përcakton se si planifikohet të zvogëlohet koeficienti i ndër-subvencionimit për shërbimet e furnizimit me ujë dhe shërbimet e ujërave të ndotura për vitet pasuese.

## Shtojca A: Zvogëlimi i ndër-subvencionimit

Koeficientet e mëposhtëm të ndër-subvencionimit do të zbatohen në përcaktimet tarifore për vitin 2026 deri në vitin 2029.

*Tabela 1 – Faktorët e subvencioneve të ndërsjella që do të aplikohen për përcaktimet e ardhshme tarifore*

Shërbimi	2024 (aktual)	2025	2026	2027	2028	2029
Furnizimi me ujë	1.5	1.4	1.3	1.2	1.1	1.0
Shërbimet e ujërave të ndotura	2.2	2.2	Vlera e koeficientit të ndër-subvencionimit mbetet subjekt i vlerësimit të më tejme nga ARRU			